

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-AR73.1

Data: 14 shkurt 2011

Originali: anglisht

KRYETARI I TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR

Para: Gjykatësit Patrick Robinson, Kryetar

Sekretari: Z. John Hocking

Urdhër: 14 shkurt 2011

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**URDHËR PËR CAKTIMIN E GJYKATËSVE NË NJË ÇËSHTJE PARA DHOMËS
SË APELIT**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

UNË, PATRICK ROBINSON, Kryetar i Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”);

DUKE MARRË SHËNIM “Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt”, lëshuar nga Dhoma Gjyqësore II, (“Dhoma Gjyqësore”) më 14 janar 2011;

DUKE MARRË SHËNIM “Vendim mbi Kërkesën e Ramush Haradinajt për Leje për Apelim Bazuar në Paragrafin (B) të Rregullës 73”, lëshuar nga Dhoma Gjyqësore më 3 shkurt 2011;

DUKE MARRË SHËNIM “Apelim në Emër të Ramush Haradinajt mbi Kuadrin e Rigjykimit të Pjesshëm”, dorëzuar nga avokati i Ramush Haradinajt më 10 shkurt 2011;

DUKE MARRË PARASYSH Nenet 12(3) dhe 14(2) të Statutit dhe Rregullat 73(B) dhe 117(C) të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit;

DUKE MARRË PARASYSH përbërjen e Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar përcaktuar në dokumentin IT/263 lëshuar më 11 maj 2009;

URDHËROJ që Trupi Gjykues në çështjen *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-AR73.1, të ketë përbërjen e mëposhtme:

Gjykatësi Patrick Robinson, Kryegjykatës

Gjykatësi Fausto Pocar

Gjykatëse Liu Daqun

Gjykatësi Andrésia Vaz

Gjykatësi Theodor Meron

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatësi Patrick Robinson
Kryetar

Sot, më 14 shkurt 2011
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]